

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ - Departamenti i Pergjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Adem Shabani, me asistentin Muedin Rexhepi në çështjen penale kundër të akuzuarit I.B., nga fshati,Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale asgjësimi dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 292 par.2 lidhur me par 1 të KPK-së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP. nr.2000-8/12 e dt.04.04.2013 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të përfaqësuesit të akuzës-prokurorit të shtetit Veton Shabani dhe të akuzuarit, me dt. 23.08.2016 solli dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari I.B., nga fshati,Komuna Ferizaj, data e lindjes....., nga i ati I. dhe e ëma M., e gjinis M., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollen e mesme, i martuar,i gjendjes së mesme ekonomike, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTORË

Sespe:

- me dt. 13.10.2012, rreth ores 12:10, në fshatin e komuna Ferizaj, duke drejtuar automjetin e mares “Golf 2” me ngjyrë të badhë me targë të regjistrimit, nuk i’u përshtat kushteve në rrugë ashtu që ka dal nga rruga dhe nga pakujdesia ka goditur shtyllën elektrike të betonit e ka thyerë e cila pastaj kishte rënë mbi vetur me atë rast ka shaktuar qrrregullim në furnizimin me energji elektrike të ndriquesve publik.

Me këtë ka kryer veprën penale asgjësimi dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 292 par.2 lidhur me par 1 të KPK-së.

Gjykata në bazë të nen. 3,34,36,39,64 të KPPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së të akuzuarin e

G J Y K O N

DËNIM ME GJOBË në shumë prej 200 €, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguan dënimin me gjobë, sipas nenit 46 par.3 të KPK-së, i njëjti dënim do t’i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t’i llogaritet një (1) ditë burgim.

E dëmtuara-përfaqësuesi i KEK-Distrikti në Feizaj, për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzime të procedurës penale të paguaj shumën prej 35,77 € uro dhe paushallit gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur aktakuzën PP. nr.2000-8/12 e dt.04.04.2013 me të cilën ka ngarkuar të akuzuarin I.B., nga fshati,Komuna Ferizaj, për shkak të veprës penale asgjësimi dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 292 par.2 lidhur me par 1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar rreth kësaj çështje penale konform nenit 245 par.1 të KPPK-së me dt.23.08.2016 ka mbajtur shqyrtimin fillestar në të cilin kanë marrë pjesë prokurori i shtetit Veton Shabani, dhe i akuzuari.

Gjykata kishte në këtë çështje penale kishte marrur veprime procedurale dhe nga fletëkthesat kishte mësuar se i akuzuari gjindet jashtë vendit e për këtë kishte lëshuar urdhresë policisë së Kosovës-Stacionit Policor në Ferizaj që për datën 06.07 2016 të akuzuarin ta sjellin në gjykat por i njeti nuk është sjellur.Pasi i akuzuari gjindet jashtë shtetit të Kosovës me punë të përkohshme në Zvicërr me të kthyer në shtëpi nga prindi i tij pshtë njoftuar se e ka kërkuar gjykata dhe i akuzuari me dt.23.08.2016 në mënyr vullnetare është paraqitur në gjykat dhe ka kërkuar nga gjykata që të vendos lidhur me rastin që akuzohet.

Në fillim të shqyrtimit fillestar gjykata të akuzuarit i dorzon një kopje të aktakuzës dhe është udhëzuar në kuptim të nenit 246.1 të KPPK-së pastaj gjyqtari gjykues ka çmuar se të drerjtat e të akuzuarit janë rerspektuar, e më pas prokurori i shtetit ka lexuar atakuzën ku gjyqtari është bindur se i njëjti e ka kuptuar në tërësi aktakuzën me të cilën është akuzuar, të njëjtit i ka dhënë mundësi të deklarohet mbi fajësinë apo pafajësinë e tij lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuar I.B. ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar ku në vazhdim të shqyrtimit fillestar ka deklaruar se atë ditë ishte në qytet në Ferizaj dhe në ndërkoh e ka njoftuar motra se nana në shtëpi është djegur me ujë të nxehtë dhe se gjendja e sajë është shumë e rëndë dhe duhet sa ma shpejtë me u kthyer në shtëpi dhe me dërguar sa ma parë në emergjencë.E nga ky njoftim për rastin ka qenë shumë i shqetësuar dhe duke u kther me veturën e tijë del nga rruga dhe e godet një shtyllë elektrike të betonit e ecil be përpara në veturen etijë e me këtë rastë vetë ka pësuar lëndime të lehta trupore a dëmet materiale të veturës kan qen të mdha si dhe është dëmtuar edhe shtylla elektrike e betonit, ka kërkuar nga gjykata që gjatë shqitimit të sanksionit penal të ketë parasysh pranimin e fajsisë dhe përshkrimin e rastit në fjalë.

Gjyqtari në kuptim nenit 248 par.1 nën.par.1.1, 1.2, 1.3, 1.4 dhe par.4 të KPPK-së, është e bindur se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht duke e mbështetur në provat që përmban aktakuza dhe në materialet e prezantuara nga ana e prokurorit të shtetit.

Pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit gjyqtari në kuptim të nenit 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit lidhur me pranimin e fajësisë, mbrojtësit dhe të dëmtuarit.

Prokurri i shtetit Veton Shabani ka theksuar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi pranimi i fajësisë është bërë konform ligjit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar se i akuzuari pranimin e fajësisë e ka mbështet në provat që gjenden në shkresat e kësaj lënde penale gjegjësisht në mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit inxh.dipl. kom.rrug.Xh.H. të dt.11.03.2013, fotografit që gjenden në shkresat e lëndës.

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit manifestohen të gjitha elementet e veprës penale asgjësimi dëmtimi ose heqja e instalimeve publike nga neni 292 par.2 lidhur me par 1 të KPK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK së të cilat ndikojnë në llojinë dhe lartësinë e dënimit, si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, ka treguar sinqeritet në procedurën penale, pendimin për veprën e kryer, mbi bazën e këtyre rrethanave gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe rrezikshmerinë konkrete të kësaj veprë penale, dhe në kuptim të të gjitha këtyre, i shqiptoi dënim me gjobë në shumë prej 200 / dyqindë/ Eurosh, të cilin dënim me gjobë është i obliguar ta paguan pasë plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, si në dispozitiv duke qenë e bindur se një dënim i tillë është në proporcion dhe raport me peshën e veprës konkrete penale, rrethanave të kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit dhe me të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale që i akuzuari të mos kryejë vepra penale si dhe në kuptim të preventivës së përgjithshme të parandalimit të kësaj veprë penale në shoqëri konform nenit 41 të KPRK-së.

Konformë nenit 463 parag.1 lidhur me par 3.të KPPK-së të dëmtuaren-përfaqësuesi i KEK-Distrikti në Feizaj për realizimin e kërkeses pasuroro-juridike udhëzohen në kontest civil.

Konformë nenit 450 par.2.6 të KPPK-së obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve gjyqësore të paguaj shumën prej 35,77 € si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nga sa u tha më lart është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P nr.813/2013 me datë 23.08.2016

Asistenti
Muedin Rexhepi

Gjyqtari
Adem Shabani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.